



Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), nenit 14, dhe 17, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, "Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr.28/2008", e në mbështetje të nenit 19, paragrafi 3, pika 3.1, të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019", e konform neneve 15, 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2019, miraton këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

znj. Luljete SYLAJ nga Suhareka; I jepet në shfrytëzim afatgjatë deri në 99, (nëntëdhjetë e nëntë) vite, Banesa, e cila gjendet në rrugën "**Brigada 123**" në Suharekë, **objekti "B"** hyrja "**H-4, Nr. 58**" sipas sistemit të unifikuar të adresave, **kati VIII**, me sipërfaqe të përgjithshme prej **S=66.31m<sup>2</sup>**, numri i banesës **Nr. B8/5**, pasurisë shoqërore në emër të Komuna e Suharekës, për banim familjarë, sipas rekomandimit të komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave.

### Neni 2

Afati për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme fillon të rrjedh nga data, **30.08.2019**, dhe përfundon afati më datën, **29.08.2118**, pas mbarimit të këtij afati ose ndërprerjes së parakohshme të kontratës e drejta e shfrytëzimit i kthehet Komunës së Suharekës si titullar faktik dhe juridik.

### Neni 3

**Obligohet** Kryetari i Komunës që pas miratimit të vendimit nga Kuvendi i Komunës së Suharekës të nënshkruan kontratë me fituesin, me anë të së cilës i përcaktojnë të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.

### Neni 4

4.1 **Obligohen** shfrytëzuesja e cekur në nenin 1, të këtij vendimi, që **pronën e paluajtshme** të cekur në nenin 1, të këtë vendim, ta shfrytëzon me mirëbesim si nikoqire e mirë, që mos t'ia humbë vlerën e saj.


4.2 Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Suharekës dhe si e tillë ajo nuk mund t'i epet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

### Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008", nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr-10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

## K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë S U H A R E K Ë

01-Nr-016-62008  
Më datë 30.08.2019



Kryesuesi i Kuvendit  
  
**Bexhet KUÇI**